



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Ministria e Arsimit dhe Sportit, duke u mbështetur në ligjin nr. 23/2024 “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”.

Shpall kriteret
për ndarje të bursave për studentët nga Republika e Kosovës, në universitetet publike në
programet bachelor për vitin akademik 2024-2025

Kushtet dhe kriteret

Të drejtë për bursë kanë të gjithë studentët në nivelin Bachelor që studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë në Shqipëri, nga Republika e Kosovës të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara:

Kriteret e aplikimit për vitin e parë Bachelor:

- 1 Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
- 2 Të jenë të regjistruar për herë të parë në një program Bachelor në një IAL publike në Shqipëri për vitin akademik 2024-2025
- 3 Të kenë notë mesatare të studimeve të arsimit të mesëm të lartë së paku 7 (Vendimi nr. 363, datë 26.5.2022 “Për një shtesë në Vendimin nr. 436, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021–2022 e në vijim”, të ndryshuar)
(Për programet e studimit në fushat arte dhe sporte nuk aplikohet kriteri i mesatares i cituar më lart)

Në raste të mosplotësimit të kuotave për studentët e regjistruar për herë të parë në vit të parë në vitin akademik 2024-2025, kuotat do të akordohen për vitet e tjera të studimit.

Kriteret e aplikimit për vitet e ndërmjetme:

- 1 Të ketë përfunduar vitin e parë ose të dytë të nivelit Bachelor
- 2 Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve
- 3 T'i ketë përfunduar të gjitha provimet e vitit akademik paraprak të përcaktuar me program studimor dhe në afat kohor të rregullt

4 Të kenë notë mesatare të studimeve të vitit të parë ose të dytë së paku 7 sipas Vendimit nr. 363, datë 26.5.2022 “Për një shtesë në Vendimin nr. 436, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021–2022 e në vijim”, të ndryshuar

Procedura

Shpallja i dërgohet IAL-ve publike dhe afati i publikimit të kësaj shpallje do të jetë 3 ditë nga marrja e njoftimit nga MAS. Afati që kjo shpallje do të qëndrojë e publikuar në faqen web të IAL-ve do të jetë 2 javë. Studentët aplikojnë me dosje pranë institucionit përkatës sipas kriterëve të shpallura në këtë thirrje.

Pas përfundimit të këtij afati lista me kandidatët fitues do t'i përcillet MAS në një afat 1 javor nga mbyllja e shpalljes.

Informata shtesë

- Studentët nuk mund të jenë përfitues të bursës nga më shumë se një skemë e bursave nga Ministria brenda të njëjtit vit akademik.
- Lista e studentëve përfitues do të bëhet publike në web faqen e MAS.
- Shuma totale e bursës në Republikën e Shqipërisë do të jetë 1000 euro për vit akademik për secilin përfitues.
- Mosfrekuentimi i rregullt sipas përcaktimeve në rregulloret e IAL-së përkatëse përbën shkak për ndërprerjen e bursës.